LIGJ
Nr. 9365, datë 31.3.2005

PËR PROCEDURAT E NJOHJES SË ZOTËSISË JURIDIKE TË PERSONAVE JURIDIKË KISHTARË TË KISHËS KATOLIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 122 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përmban dispozitat normative për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet e ligjit

Subjekte të këtij ligji janë personat juridikë kishtarë (entet ose institucionet fetare të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë), të themeluara nga autoriteti kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike (Kodi Ligjor i Kishës Katolike).

KREU II
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3
Parimi i pavarësisë nga shteti

Personat juridikë kishtarë të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet shtetërore dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet

Personat juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në dispozitat e Kodit Civil dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi për të gjithë personat juridikë.

KREU III
PERSONAT JURIDIKË KISHTARË

Neni 5
Forma e personave juridikë kishtarë

Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, modifikimi dhe mënyrat e mbarimit të personave juridikë kishtarë realizohen në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe me këtë ligj.

Neni 6
Njohja e personalitetit juridik të personave juridikë kishtarë dhe regjistrimi i tyre

1. Personat juridikë kishtarë, subjekte të këtij ligji, njihen si persona juridikë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, në bazë të dokumenteve të mëposhtme:
a) kërkesës për njohjen juridike nga përfaqësuesi ligjor të personit juridik kishtar;
b) aktit të themelimit të personit juridik kishtar nga autoriteti kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike, ku përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë;
c) statutit të personit juridik kishtar, sipas së Drejtës Kanonike, ku përcaktohen përfaqësuesi ligjor, detyrat dhe kompetencat e tij, burimet e financimit dhe mënyrat e mbarimit të personit juridik kishtar të parashikuara në statutet e secilit.
2. Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe të dokumentacionit të mësipërm, bën njohjen e personit juridik kishtar dhe regjistrimin e tij, duke lëshuar vendimin përkatës.

Neni 7
Regjistrimi në organet tatimore

Pas përfundimit të procedurave të regjistrimit në gjykatë, personat juridikë kisharë kryejnë regjistrimin në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 8
Kohëzgjatja dhe shtrirja territoriale e personave juridikë kishtarë

Personat juridikë kishtarë mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre për një kohëzgjatje pa afat dhe kjo veprimtari mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9
Statusi juridik dhe fiskal

Personat juridikë kishtarë nuk kanë qëllime fitimi dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tyre gëzojnë të gjitha të drejtat dhe lehtësitë fiskale, si dhe përmbushin detyrimet ligjore, si të gjithë personat juridikë jofitimprurës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 10
Licencimi

Personat juridikë kishtarë, përveç veprimtarisë së tyre fetare, kanë të drejtë të zhvillojnë edhe veprimtari të tjera, si në fushën e arsimit, atë shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me legjislacionin shqiptar për marrjen e licencave ose të lejeve përkatëse.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 11
Njohja e zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë, që nuk kanë zotësinë juridike ose që janë regjistruar si organizata jofitimprurëse

Për të fituar njohjen e zotësisë juridike, personat juridikë kishtarë, të pranishëm në Republikën e Shqipërisë, të themeluar nga organi kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike, që nuk e gëzojnë zotësinë juridike, si dhe personat e regjistruar si organizata jofitimprurëse para miratimit të këtij ligji duhet që, brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të tij, të paraqesin në gjykatë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4539, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu